

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	By Pass-i i Elbasanit, Himçi: Dy lotet nuk mjaftojnë; Karakaçi: Faza e tretë buxhetohet në 2027
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/by-pass-i-i-elbasanit-himci-dy-lotet-nuk-mjaftojne-k-arakaci-faza-e-tret-i586692
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:12:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a55a394cc54241b792327cc512a1cdf10751ecaf3bcd258b6f7dbcaa8a90c81
TEKSTI	f841c3f4a2239c14512762c4caf8f1aa77572fca2cd4417210629bfa5f2061be
PAMJA	ead6714244b37a162e597065e9b998ab28abd0af0f51dc40a3efa5121a9c32ff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c3efde4e9a11513e4e7340549ca7255c6cf0d398193419e52385d1e978a2faf1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c3efde4e9a11513e4e7340549ca7255c6cf0d398193419e52385d1e978a2faf1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le Alarmit rreme per bombe ne shkollen "Emin Duraku," "detyrim paraqitje" per Mandi Jataganin: Do ta bej serish nese... Andrej Kurkov vjen ne CODirani i pergjigjet Merzit fundit

By Pass-i i Elbasanit, Himçi: Dy lotet nuk mjaftojnë; Karakaçi: Faza e tretë buxhetohet në 2027



17 Shtator 2026, 15:30Politika TEMA



Deputeti demokrat Blendi Himçi, në interpelancën me ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, shtroi disa pyetje lidhur me ecurinë e projektit të By Pass-it të Elbasanit, afatet e përfundimit dhe lidhjen e tij të plotë me Korridorin VIII. Himçi kërkoi informacion se kur pritet të përfundojë i gjithë projekti, duke theksuar se ende nuk ka nisur tenderimi për të gjitha pjesët e tij. Deputeti ngriti gjithashtu shqetësimin për afatin e parashikuar prej 24 muajsh për përfundimin e punimeve.

“Që të përfundojë totalisht By Pass-i, ende nuk kemi tenderim dhe nuk dimë kur do të përfundojë ky By Pass, që të lidhet me Korridorin 8. Një tjetër problematikë është që ju e keni vendosur 24 muaj afatin e përfundimit. Përse duhet të presin qytetarët edhe dy vite që të përfundojë By Pass-i i Elbasanit?”, pyeti deputeti.

Sipas Himçit, përfundimi i vetëm dy loteve nuk do të ishte i mjaftueshëm nëse projekti nuk lidhet plotësisht me Lotin 3. “Nëse përfundojnë dy lote dhe nuk lidhet me Lotin 3, situata nuk është lidhur përfundimisht”, shtoi ai.

Në përgjigje, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, deklaroi në Kuvend se By Pass-i i Elbasanit është një projekt me vlerë të konsiderueshme infrastrukturore, që synon të lehtësojë trafikun urban dhe tranzit në qytet.

“By Pass-i i Elbasanit është një projekt kompleks infrastrukturor. Ky është një investim me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe cilësisë së jetesës së qytetarëve.”

Sipas Karakaçit, projekti do të ndajë trafikun tranzit nga ai urban dhe do të ndikojë në reduktimin e kohës së udhëtimit dhe kostove të transportit. “Ky By Pass do të ndajë trafikun tranzit nga ai urban, duke lehtësuar ndjeshëm qarkullimin e tij dhe duke reduktuar kohën e udhëtimit, në varësi se cila është pika fundore, mbi 10 minuta përkatëse, dhe duke ulur kostot e transportit për qytetarët dhe bizneset.”

Ministri theksoi gjithashtu rëndësinë e projektit për lidhjen e Elbasanit me Korridorin VIII dhe rrjetin kombëtar të transportit. “Do të përmirësojë lidhjen e Elbasanit me Korridorin 8 dhe rrjetin kombëtar të transportit.”

Karakaçi bëri të ditur se projekti inxhinierik është përfunduar dhe i është dorëzuar ARRSH-së. Vlera indicative për tre lotet është rreth 240 milionë euro.

“Projekti inxhinierik për By Pass-in e Elbasanit është realizuar dhe i është dorëzuar pranë ARRSH-së dhe ka vlerë indicative prej 240 milionë euro për të tre lotet e tij.”

Për shkak të kostonë së lartë të projektit, ministri tha se financimi do të mbështetet në burimet e buxhetit të shtetit dhe financimet e huaja. Sipas ministrit, puna në terren ka nisur për Lotin 1, ndërsa po vijon edhe faza e dytë. Ky lot ka një vlerë prej 90 milionë eurosh.

“Për shkak të vlerës së lartë të investimit, qasja jonë ka qenë që realizimi i tij të mbështetet në burimet e buxhetit të shtetit dhe në financimet e huaja. Kemi nisur punën në terren për fazën e parë të Lotit 1 dhe po vijohet dhe për fazën e dytë të Lotit 1”, tha ai.

Karakaçi deklaroi se dy fazat e para janë prokuruar dhe kontratat janë lidhur, ndërsa faza e tretë është buxhetuar për vitin 2027. Ministri tha se procedura për fazën e fundit të Lotit 1 pritet të nisë në muajt shtator-tetor.

“Loti 1 ka vlerë 90 milionë euro. Ne kemi prokuruar fazën e parë të Lotit 1, fazën e dytë, janë lidhur kontratat dhe faza e tretë e Lotit 1 është buxhetuar në vitin 2027. Për shkak të ligjit të buxhetit do të fillojë dhe do të vijojë prokurimi për fazën e fundit të Lotit 1 në muajin shtator-tetor, për të filluar punën menjëherë për të trija fazat e Lotit 1”, theksoi ministri.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Ministria Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dorëheqjen](#)

14:00 Politika / 3 komente

[FOTO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD](#)

12:35 Politika / 10 komente

[Kumbaro në Kuvend: Shqipëria përmirësoi rezultatet në PISA, përzgjedhja e shkollave u bë sipas metodologjisë së OECD-së](#)

12:12 Politika / 5 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.